Aktualitet

Europol operacion në 34 shtete/ Në Shqipëri u ndaluan 7 persona, 2 prej tyre në kërkim ndërkombëtar! Sekuestrohen 6 armë zjarri dhe një sasi droge

*Gjatë këtij plani operacional në Shqipëri janë **kontrolluar 2422 persona, 2032 automjete, 126 ambiente të ndryshme dhe 90 pako postare**. Gjatë zhvillimit të operacionit të përqendruar në kontrollet kufitare ne vendin tonë u arrestuan 7 shtetas shqiptar dhe të huaj, ndërsa 8 shtetas shqiptar dhe të huaj u proceduan në gjendje të lirë.*

Armet e sekuestruara

Redaksia
30 Shtator, 16:47 | Përditesimi i fundit: 30 Shtator, 17:39

Europol ka zhvilluar një operacion 4 ditor të shtrirë në 34 shtete për goditjen e krimit në fushën e imigracionit të paligjshëm dhe trafikimin e armëve të zjarrit dhe drogës.

Pjesë e operacionit ishte edhe Shqipëria ku policia ka bërë të mundur arrestimin e 7 personave, mes tyre shqiptarë dhe të huaj si dhe po ndjek në gjendje të lirë 8 persona të tjerë.


LEXO EDHE:
VIDEO - Arrestohet në Gjirokastër vrasësi me pagesë, ekzekutoi me eksploziv një person në Gjakovë (EMRI)

Gjatë operacioni janë në vendin tonë janë kontrolluar 2422 persona, 2032 automjete, 126 ambiente të ndryshme dhe 90 pako postare. Nga kontrollet janë sekuestruar 6 armë zjarri, nga të cilat 2 armë gjahu, 1 automatik, 3 pistoleta dhe 117 municione të ndryshme të armëve të zjarrit. Gjithashtu u sekuestruan një sasi në paund, lëndë narkotike cannabis dhe një sasi e vogël kokaine.

Mes 7 të arrestuarve, 2 prej tyre ishin në kërkim ndërkombëtar,, një shqiptar i dënuar me 10 vjet burgim për trafikim të narkotikëve dhe një tjetër i shpallur në kërkim nga Kroacia, i dënuar 7 vjet e 7 muaj burgim për pjesëmarrje në grup kriminal, me qëllim trafikimin e lëndëve narkotike.

Gjithashtu në fushën e emigracionit të paligjshëm në pikat kufitare në Kapshticë dhe Kakavijë, në bashkëpunim edhe me FRONTEX-in, janë kapur 411 emigrantë të parregullt të kombësive të ndryshme, si dhe janë bllokuar në kufi 2 pasaporta të vjedhura.

Në këtë ***operacion*** u përfshinë 8838 oficerë të Policisë, të rojës bregdetare, kufitare tokësore, detare dhe ajrore dhe agjentë doganorë, ku në rang ndërkombëtar hetuesit sekuestruan 51 armë të llojeve të ndryshme dhe 47 kilogramë drogë e llojeve të ndryshme.

Operacioni 'SEE JAD' në 34 shtete/Në Shqipëri u ndaluan 7 persona, 2 prej tyre në kërkim ndërkombëtar!

1 / 6

Droga e sekuestruar

I.K./D.P./Shqiptarja.com

TAG: Arrestime | europol

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A jeni dakord që kryetari i partisë të garojë në 4 zona zgjedhore njëkohësisht?
Po | Jo | Nuk kam mendim

Komento

Komente

LORA: 30/09/2020 17:20
Kane emra keta te arrestuarit?
Përgjigju

Lajme të tjera

Aktualitet

Tirana hyn në epokën digjitale, gati 'Tumo Center', Veliaj: Mezi pres ta kthejmë në një tjetër histori suksesi! Këtë muaj fillojmë punimet te Piramida
3 Tetor, 11:23

Aktualitet

I dha bukë e ujë nipit të burrit, ai abuzoi, e vrau dhe më pas hodhi trupin në rezervuar! Mbyllen hetimet dërgohen në gjyq tre 'monstrat' e Mallakastrës
Elton Qyno
3 Tetor, 10:58

Aktualitet

Përmirësimi i motit/ Qytetarët e Kosovës dynden drejt Shqipërisë në fundjavë, fluks i madh në Morinë
3 Tetor, 10:51

Aktualitet

130 kg eksploziv për prishjen e pallatit 14 katesh në Durrës, IKMT pritet të kryej shpërthim të kontrolluar
3 Tetor, 10:48

Aktualitet

6 ditë grevë urie/ Naftëtarët e Ballshit: Gjendja jonë e rënduar vjen nga shpërfillja e instancave! Të kthejnë përgjigje qoftë edhe negative
3 Tetor, 10:21

Aktualitet

Leonidha Çobo përfitoi miliona lekë nga kompania e të vëllait përmes llogarisë së bashkëshortes! 'Tea CO' nënkontraktore e 'Bankers Petroleum'
3 Tetor, 10:01

MINUTË PAS MINUTE

12:09 Ndërtimi i Skavicës, Rama: Mirëpresim investimet e vendeve mike, jemi të kujdesshëm për paratë e vendeve jo mike
11:50 Erdogan zbulon kartat dhe i jep mbështetje të plotë Azerbajxhanit! Armenët protestojnë në Washington
11:47 Nënshkrimi i marrëveshjes për ndërtimin e Skavicës, Rama: Mirëpresim investimet e vendeve mike, jemi të kujdesshëm për paratë e vendeve jo mike
11:35 Dita e 6 e grevës me probleme shëndetësore, naftëtarët refuzojnë të vizitohen
11:25 Tirana hyn në epokën digjitale, gati 'Tumo Center', Veliaj: Mezi pres ta kthejmë në një tjetër histori suksesi! Këtë muaj fillojmë punimet te Piramida

Me te lexuarat e dites | Me te lexuarat e javes
Lajme | Fotogaleri | Videogaleri

1. Ekskluzive/Berisha krijoi formacion me 111 kriminelë dhe i pajisi me raketa në '97, liroi nga burgu krerët e bandave, u dha pasaporta diplomatike
2. Elbasan/Sherr mes të rinjve me gota e shishe në një lokal, një i plagosur (VIDEO)
3. 'Fake News-i' për mbetjet nga Italia në Shqipëri, Rama 'sulmon' Metën: Çfarë shëmtie, të paguash para të zeza për të përhapur në botë shpifje për vendin ku të kanë bërë president
4. U konfirmua me COVID-19, Donald Trump shtrohet në spital! Mjekët: Është në gjendje të mirë, por rrezikon për shkak të moshës
5. I dha bukë e ujë nipit të burrit, ai abuzoi, e vrau dhe më pas hodhi trupin në rezervuar! Mbyllen hetimet dërgohen në gjyq tre 'monstrat' e Mallakastrës
6. Ditë plot energji dhe pozitive, çfarë thonë yjet për ju sot
7. Leonidha Çobo përfitoi miliona lekë nga kompania e të vëllait përmes llogarisë së bashkëshortes! 'Tea CO' nënkontraktore e 'Bankers Petroleum'
8. 130 kg eksploziv për prishjen e pallatit 14 katesh në Durrës, IKMT pritet të kryej shpërthim të kontrolluar
9. Iu gjet me 4 kg kanabis e bimë narkotike në banesë, pranga 62-vjeçarit në Tropojë
10. Me shpejtësi të frikshme deri në 202 km/h, pezullim patentash për 'pilotët' e natës në Sauk-Teg (VIDEO)

© 2011 - 2020 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje